

❖ PERSHKRIM I SHKURTER I KOMPANISE

Gener 2 është një nga kompanitë më të mëdha private të ndërtimit dhe zhvillimit të infrastrukturës në Shqipëri. Portofoli i Gener 2 është i diversifikuar në zhvillimin e industrive të tilla si: ndërtim, infrastrukturë dhe menaxhim projektsh inxhinierike, energji dhe telekomunikacion, menaxhim pronash, pasuri të paluajtshme dhe media. Gjatë 20 viteve të fundit, Gener 2, ka lënë gjurmë në tregun shqiptar dhe atë rajonal duke zhvilluar projekte strategjike me standartet më të larta ndërkombëtare e njëkohësisht duke kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit.

❖ TITULLI I POZICIONIT TE PUNES

Drejtor Kantieri

❖ PERSHKRIMI I POZICIONIT

Roli kryesor i Drejtorit të Kantierit është të sigurojë implementimin e projektit në mënyrë të sigurtë, brenda buxhetit dhe në përputhje me programin e punimeve të miratuar nga Departamentet Drejtuese. Menaxhon regullisht operacionet e kantierit dhe mbikqyr stafin inxhinierik të kantierit, grupet operacionle, monitoron zbatimin e punës së nënkotraktorëve në përputhje me kontratat, koordinon mjetet dhe makineritë e kantierit. Realizon inspektime për të siguruar cilësinë maksimale në realizimin e punëve. Jep zgjidhje inxhinierike për problematika të paparashikuara në projekt.

❖ DETYRAT KRYESORE

Konkretisht, roli i Drejtorit të Kantierit është të drejtojë ekipin zbatues të projektit dhe specialistët teknikë.

Kandidati i përzgjedhur duhet të shfaqë aftësi të mira organizative dhe të sigurojë mbarëvajtjen e të gjithë fazave të projektit duke përfshirë komunikimin me klientin (punëdhënësin) koordinimin dhe drejtimin administrativ të stafit, siguron mbarëvajtjen e prokurimeve dhe makinerive në përputhje me projektin e zbatimit, specifikimet teknike, grafikun e punimeve dhe buxhetit të miratuar.

- Përgatit dhe ndjek zbatimin e plan organizimit të punimeve, dhe propozon për amendimin e ketyre planeve sipas nevojës;
- Ndihmon në përgatitjen e metodologjise së punimeve të përgjithshme ose specifike për punimet civile, dhe propozon për amendimin e ketyre metodologjive sipas nevojës;
- Ben planifikimin ditor/javor/mujor të punimeve dhe ndjek zbatimin e tyre duke planifikuar ecurinë sipas grafikut të miratuar dhe jep rekomandimet e nevojshme në kohë të eprorit për masat korrigjuese që duhet të merren;
- Mban përgjegjësi për koordinimin dhe zbatimin e punimeve nga grupet e punës në kantier në përputhje me projektet e zbatimit, preventivin, specifikimet teknike dhe standartet;
- Mban përgjegjësi për ndjekjen e procedurave dhe plotësimin e dokumentave të nevojshme nga gjithë personeli i projektit.
- Planifikon në kohë porositë e materialeve, pajisjeve dhe makinerive të nevojshme për realizimin e projektit dhe plotëson dokumentacionet e nevojshme të marrjes në dorezim të tyre;
- Në bashkëpunim me koordinatorin e cilesise, ndjek kryerjen e analizave dhe provave të materialeve në laboratore dhe atyre që behen në kantier;
- Bashkëpunon me përgjegjësin e sektorit inxhinierik, burimeve, sektorit të standarteve, për zgjidhjen e të gjithë problematikës dhe mbarevajtjen e punës në objekt në përputhje me politikat dhe procedurat e kompanisë në funksion të:
 - Sigurimit Teknik dhe Shendetit

- Mbrojtjes se Mjedisit
 - Cilesise
- Pergjegjesise Sociale ne Komunitet dhe ndaj Paleve te Interesit.

❖ KRITERET KRYESORE

- Te jetë i diplomuar në Inxhinieri Ndërtimi.
- Te kete njohuri të mira të gjuhës angleze dhe një prej gjuhëve te tjera te EU.
- Te ketë minimumi 7 vite eksperiencë pune në projekte infrastrukturore.
- Te ketë minimalisht 3 vjet eksperiencë të vazhdueshme në organizimin e kantierëve, me referenca te faktuara ne monitorim/implementim dhe finalizimin me sukses të tyre.
- Të jetë njohës i programeve baze mbi planifikimin e projekteve (Microsoft Project/Primavera)
- Të shfaqë aftësi te mira analitike dhe raportuese.
- Të ketë aftësi te mira komunikuese me shkrim dhe verbal.
- Te ketë aftesi organizative për prioritizimin e çështjeve dhe direktivave në një ambient shumë dinamik.

Te gjithë te interesuarit, jane te lutur qe te dergojne CV nepermjet adreses se e-mailit careers@gener2.al ose te plotesojne formularin e aplikimit ne faqen zyrtare www.gener2.al ne seksionin “apliko online”.

Afati i fundit i aplikimit eshte **data 03 Prill 2026, ora 17:00**.

* Vetem kandidatet e perzgjedhur do te kontaktohen.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr. 9887 mbi “Mbrojtjen e të dhënave personale”.